

DEFIÇITI DEMOKRATIK *VERSUS* DEMOKRACIA DELIBERATIVE NË KONTEKSTIN E  
POLITIKËS SË ZGJERIMIT TË BASHKIMIT EUROPIAN

MALVINA TEMA\*

*Abstrakt*

Ky punim do të shqyrtojë cilësinë e demokracisë në BE duke u fokusuar në dinamikat specifike që lidhen me Politikën e Zgjerimit të Bashkimit Europian. Edhe pse me shumë dimensione, debati mbi *defiçitin demokratik* në Bashkimin Europian në radhë të parë ka të bëjë me qasjet se si BE-ja mund të prodhojë politika më transparente dhe të përgjegjshme. Për më tepër, dimensionet institucionale dhe social-psikologjike të problemit përbëjnë variabla të forta për të analizuar këtë çështje. Sa i përket cilësisë së demokracisë në BE, ekziston një dilemë themelore në lidhje me konsultimin publik i cili siguron atë që quhet 'input' demokraci përkundrejt 'output' demokracisë, ku elitat janë të vendosura në majë të piramidës së vendimmarrjes. Për më tepër, në çdo fazë të procesit të integritit europian, çështja e *legjitimitetit demokratik* bëhet gjithnjë e më delikate. Pyetja -deri në çfarë mase ende në ditët e sotme BE-ja vuan nga një defičit demokratik dhe –a eksportohet ky problem përmes procesit të integritit, -përbën një pikë të rëndësishme për të ardhmen e Unionit. Këto çështje do të trajtohen nëpërmjet kësaj eseje, duke nisur me një hyrje të përgjithshme të çështjes, e ndjekur nga adresimi i *defiçitit demokratik* dhe më tej duke vijuar me shqyrtimin e lidhjes së *defiçitit demokratik* me Politikën e Zgjerimit të BE-së. Eseja si përfundim përmbyllet me vërejtjet përmbledhëse.

*Fjalë Kyçe:* BE; Defičiti Demokratik; Demokracia Deliberative; Politika e Zgjerimit të BE-së

\*

*Artikulli së spejti do publikohet*

© DKE 2013

<http://www.southeast-europe.org>  
Contact: [dke@southeast-europe.org](mailto:dke@southeast-europe.org)

\*

---

\* Autore: *Malvina Tema*, Doktorante dhe Pedagoge - *Universiteti Europian i Tiranës*, Shqipëri.